



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. HONORORIA e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar më datë 23.04.2021, Nr. rregj.them **5/9/18/89** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: Gjykimin çështjes penale në ngarkim të të pandehurve: **Mitat Cani**, akuzuar për kryerjen e veprave penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e parashikuar nga neni 259/1 i K.Penal, dhe "*Shpërdorimi i detyrës*", kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 248 - 25 të Kodit Penal, **Edmond Terolli**, akuzuar për kryerjen e veprës penale "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", e parashikuar nga neni 245/1 parag. 3 i K.Penal, **Saimir Koçibelli**, akuzuar për kryerjen e veprës penale "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", e parashikuar nga neni 245/1 parag. 3 i K.Penal, **Ervin Dervishi** akuzuar për kryerjen e veprës penale "*Shpërdorimi i detyrës*", kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 248 - 25 të Kodit Penal; **Agron Hima** akuzuar për kryerjen e veprës penale "*Shpërdorimi i detyrës*", kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 248 - 25 të Kodit Penal; **Oltion Hyka** akuzuar për kryerjen e veprës penale "*Shpërdorimi i detyrës*", e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; **Enver Mukades**, akuzuar për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e parashikuar nga neni 244/1 i Kodit Penal.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët Erjon Çela, Flora Hajredinaj dhe Etleva Deda, me Vendimin Nr. 37, datë 12.06.2024 vendosi:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Mitat Cani** për kryerjen e veprës penale "*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*" e parashikuar

- nga neni 259/1 i K.Penal (*ndryshuar me ligjin nr. 43/2021, dt. 23.03.2021*) dhe në bazë të kësaj dispozite dënimit e tij me 2 (dy) vjet burgim.
2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Mitat Cani** për kryerjen e veprës penale "*Shpërdorimi i detyrës*", kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 248 - 25 të Kodit Penal dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimit e tij me 1 (një) vit burgim.
 3. Në aplikim të nenit 55 të K.Penal mbi caktimin e dënimit për kryerjen e dy veprave penale, dënimit e të pandehurit **Mitat Cani** me një dënim të vetëm prej 2 (dy) vjet burgim.
 4. Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Mitat Cani** do të fillojë nga dita e marrjes formë të prerë të këtij vendimi dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së zakonshme.
 5. Në zbatim të nenit 35 të K.Penal, heqjen e të drejtës për të pandehurin **Mitat Cani** për të ushtruar funksione publike për një afat kohor 5 (pesë) vjeçar.
 6. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Edmond Terolli** për kryerjen e veprës penale "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", e parashikuar nga neni 245/1 paragraf 3 i K.Penal (*ndryshuar me ligjin nr. 43/2021, dt. 23.03.2021*), pasi në bazë të nenit 388/1/d të K.Pr.Penale nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën penale që akuzohet.
 7. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Edmond Terolli** për kryerjen e veprës penale "*Shpërdorimi i detyrës*", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 248 – 25 i K.Penal, pasi në bazë të nenit 388/1/c të K.Pr.Penale, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.
 8. Pushimin e gjykimit të çështjes për akuzën "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*", e parashikuar nga neni 245/1 paragraf 3 i K.Penal (*ndryshuar me ligjin nr. 43/2021, dt. 23.03.2021*), në ngarkim të të pandehurit **Saimir Koçibelli**, pasi në zbatim të nenit 387/1 të K.Pr.Penale dhe ligjit nr. 33/2024 '*Për dhënie amnistie*', ndjekja penale për këtë vepër penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë.
 9. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Ervin Dervishi** për kryerjen e veprës penale "*Shpërdorimi i detyrës*", kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 248 - 25 të Kodit Penal dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimit e tij me 1 (një) vit burgim.

10. Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Ervin Dervishi** do të fillojë nga dita e marrjes formë të prerë të këtij vendimi dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së zakonshme.
11. Në zbatim të nenit 35 të K.Penal, heqjen e të drejtës për të pandehurin Ervin Dervishi për të ushtruar funksione publike për një afat kohor 5 (pesë) vjeçar.
12. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Agron Hima** për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 248 - 25 të Kodit Penal dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.
13. Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Agron Hima** do të fillojë nga dita e marrjes formë të prerë të këtij vendimi dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së zakonshme.
14. Në zbatim të nenit 35 të K.Penal, heqjen e të drejtës për të pandehurin Agron Hima për të ushtruar funksione publike për një afat kohor 5 (pesë) vjeçar.
15. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Oltion Hyka** për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe në bazë të këtyre dispozitave dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.
16. Vuajtja e dënimit për të pandehurin **Oltion Hyka** do të fillojë nga dita e marrjes formë të prerë të këtij vendimi dhe do të kryhet në një IEVP, burg i sigurisë së zakonshme.
17. Në zbatim të nenit 35 të K.Penal, heqjen e të drejtës për të pandehurin **Oltion Hyka** për të ushtruar funksione publike për një afat kohor 5 (pesë) vjeçar.
18. Pushimin e gjykimit të çështjes për akuzën "*Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*", e parashikuar nga neni 244/1 i Kodit Penal (*ndryshuar me ligjin nr. 43/2021, dt. 23.03.2021*), në ngarkim të të pandehurit **Enver Mukades** pasi në zbatim të nenit 387/1 të K.Pr.Penale dhe ligjit nr. 33/2024 '*Për dhënie amnistie*', ndjekja penale për këtë veprë penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë.
19. Në aplikim të nenit 190/1 shkronja "ç" të K.Pr.Penale provat materiale, dokumentacioni i praktikave të zhbllokimit të automjeteve, bashkuar me çështjen sipas urdhërit të datës 29.12.2020, ti kthehen Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë. Prova materiale një kompjuter Desktop, i markës Lenovo me numër serial SN:S100LA3D, ti kthehet të pandehurit Ervin Dervishi.

20. Mbrojtësi i caktuar kryesisht nga gjykata për të pandehurit e këtij gjykimi av. Pranvera Doçi të shpërblehet nga shteti sipas tarifave të miratuara me ligj.
21. Shpenzimet procedurale gjatë fazës së hetimit si dhe shpenzimet gjyqësore i lihen në ngarkim të pandehurve Mitat Cani, Saimir Koçibelli, Ervin Dervishi, Agron Hima, Oltion Hyka dhe Enver Mukades në mënyrë solidare.
22. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim nga palët brënda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

Tiranë, më datë 12.06.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar